

FAIK KONICA

PUNOI:NDERIM JASHARI

LENDI:GJUHE SHQIPE

FAIK KONICA

- **Faik bej Konica** (Konicë, 15 mars 1875 - Uashington, 1 dhjetor 1942) ka qenë figurë qëndrore e lëvizjes kombëtare, studiues i historisë dhe gjuhës shqipe, botues, publicist, drejtues i *Vatrës* dhe diplomat shqiptar. Ministri fuqiptotë i Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e përkohshmja e tij *Albania* ka qenë ndër tribinat e publicistikës shqiptare për trembëdhjetë vjet. Vetë Konica është i njohur për erudicionin, publicistikën, stilin dhe ndikimin që pati në kulturën dhe politikën shqiptare.
- Është po ashtu autor i dy romaneve të shkruar në gjuhën frënge me nofkën *Jean de Croia* (sq. *Gjoni i Krujës*), *Le mariage de Leila suivi de Sotiri et Mitka* (Martesa e Lejlës pasuar nga Sotiri dhe Mitka) botuar më 1911 në Paris.



BIOGRAFIA

- U lind në Konicë, në oxhakun e bejlerëve të njohur si Zenelbejllinjë, i biri i Shahin beut dhe Zeliha hanëm Delvinës, i treti ndër katër djemtë, Mehmeti, Rustemi dhe Hilmiu. Muaji i lindjes figuron i dokumentuar në prill - ndryshim që mbase lidhet me ndryshimet në kalendaret e zbatuara në atë periudhë.
- Mësimet e para i mori në vendlindje nga mësuesë privatë. Më 1883 vizitoi të motrën, Xheva hanëm që në atë kohë banonte në Shkodër. Ndoqi shkollën saveriane në dy vite shkollore 1883-1885 ku ndoqi lëndë në italisht, latinisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Kthehet në vendlindje për ndoshta një vit dhe më pas vijoi shkollimin në Liceun Perandorak të Gallatasarajit në Stamboll gjatë viteve 1886-1887.

BIOGRAFIA

- Filloi studimet universitare më 1890 në Collège de Lisieux në Normandi; më 1893 ai shkoi në Lycée de Carcassonne në jug të Francës ku studioi deri më 1894, duke u përqëndruar në studimet klasike, letërsi dhe filozofi. Më 1893, gjatë “Année du Rhétorique” doli studenti i parë i kursit në lëndën e kompozicionit në frëngjisht dhe në përkthimet latine. Përfundoi studimet universitare me diplomën of Bachelier de l’Enseignement Secondaire Classique (Lettres – Philosophie) në Fakultetin e Letërsisë të Dizhonit (Université de France) më 16 nëntor 1895, ku u pagëzua i krishterë katolik me emrin *Domenik*, që e ka përdorur edhe në një letërkëmbim "beg Faik - Dominik Koniza". Në vitet 1895-1896, Konica filloi studimet pasuniversitare tek Collège de France në Paris, ku u përqëndrua në “letërsinë mesjetare frënge, dhe letërsi romake”.

BELGJIKË, ANGLI, AMERIKË

- Gjatë qëndrimit në Bruksel, në vitet 1896 dhe 1897 Konica filloi botimin e periodikut Albania, me botim që përfundon në vitin 1909, pasi u nis për në SHBA. Është shtypur si në Bruksel ashtu edhe në Paris. Revista ishte një nga revistat rilindas më të rëndësishme të asaj kohe.
- Më 1903 u shpërngul në Londër, ku mori leje të punonte në Departamentin e Dorëshkrimeve të Muzeumit Britanik. Në Londër jetoi pesë vjet dhe studioi dokumentet shtetërore veneciane që lidheshin me Shqipërinë si dhe me dorëshkrime të tjera, disa prej të cilave i botoi tek “Albania”. Në 1909 u ftua prej shqiptaro-amerikanëve të shkonte në Shtetet e Bashkuara, ku të jepte një varg leksionesh, që e bëri në dyvjeçarim 1909-1911.
- Më 1912 u diplomua për letërsi në universitetin e Harvardit të SHBA me medalje ari, ndërkohë që është cilësuar nga miqtë e tij si "biblioteka lëvizëse".



Ju faleminderit!